

VENDIM
Nr. 282, datë 7.11.2022

**MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s LIDHUR ME
FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS SË SHOQËRISË
“DOSKU-ENERGY” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 67 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1885/3-1 prot., datë 7.11.2022, të drejtorive teknike, Sekretarit të Përgjithshëm dhe Këshilltares së Bordit, “Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s lidhur me fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë ‘Dosku-Energy’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Në adresën e postës elektronike të ERE (*e-mail*, datë 7.11.2022), protokolluar në ERE më datë 7.11.2022, me nr. 207/36 prot., përfaqësuesi ligjor i shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për shtyrjen e vendimmarrjes së bordit të ERE-s lidhur me procedurën e nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 21.7.2022, për heqjen e licencës së shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k.

- Shoqëria, në kërkesën e saj pretendon, se: “Administrata e ERE-s do të vinte në dispozicion raportin paraprak me gjetjet përkatëse, në mënyrë që shoqëria “Dosku-Energy” sh.p.k. të kishte mundësi të njihej me to, të ushtronte të drejtën e mbrojtjes, të paraqitjes së provave dhe të dokumentacionit të nevojshëm, nëse do të ishte e nevojshme.

- Shoqëria “Dosku Energy” sh.p.k., në mbledhjen e datës 6.10.2022, dhe në vijim me *e-mail*, në datën 11.10.2022, ka kërkuar një kopje të të gjitha provave të paraqitura në ERE nga “C&S Construction Energy” sh.p.k., ERE, me shkresën nr. 207/33 prot., datë 28.10.2022, i ka dërguar kësaj shoqërie dokumentacionin e kërkuar.

- Në nenin 67 të “Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar, se: “organi publik, që është kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar, mund të marrë edhe vendime të ndërmjetme, kur gjykohet se mosmarrja e masave të caktuara do të shkaktonte një dëm të rëndë e të pariparueshëm mbi interesin publik, apo të të drejtave ose interesave të ligjshëm të palëve.

Gjithashtu, në nenin 87, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” parashikohet se përpara se të merret vendimi përfundimtar, organi publik, njofton palën lidhur me të drejtën e saj për t’u dëgjuar.

- Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 67 dhe nenit 87 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, vlerësohet zgjatja e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s lidhur me procedurën e nisur me vendimin nr. 188, datë 21.7.2022, në lidhje me fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k., deri në 30 ditë nga marrja dijoni e këtij vendimi.

- Pretendimi i shoqërisë që administrata e ERE-s duhet t’i vendoste në dispozicion “raportin paraprak me gjetjet përkatëse”, në mënyrë që shoqëria “Dosku-Energy” sh.p.k., të kishte mundësi të njihej dhe të ushtronte të drejtën për t’u mbrojtur, është i paqartë, pasi ERE nuk disponon dokumentacion me titull apo përmbajtjen e sipërcituar, ndaj vlerësohet që brenda datës 10.11.2022, shoqëria “Dosku-Energy” sh.p.k. të saktësojë objektin e kërkesës së saj të datës 7.11.2022, në lidhje me administrimin e dokumentacionit të kërkuar nga ana e saj.

- Me qëllim që t’i mundësohet ushtrimi i të drejtave që burojnë nga neni 87 i KPA-së, vlerësohet t’i lihet afat shoqërisë që brenda datës 18.11.2022, të paraqesë në ERE komente apo vlerësime të mundshme mbi dokumentacionin e dërguar me shkresën e ERE-s nr. 207/33 prot., datë 28.10.2022.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 ditë vendimmarrjen e Bordit të ERE-s lidhur me fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “Dosku Energy” sh.p.k.

2. Brenda datës 10.11.2022, shoqëria “Dosku-Energy” sh.p.k. të saktësojë objektin e kërkesën e saj të datës 7.11.2022, në lidhje me administrimin e dokumentacionit të kërkuar nga ana e saj.

3. Brenda datës 18.11.2022, shoqëria “Dosku Energy” sh.p.k. të parashtojë në ERE komente apo vlerësime mbi provat e administruara, si dhe çdo argument që i shërben ushtrimit të së drejtës për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur për aq sa është administruar nga shoqëria me shkresën e ERE-s nr. 207/33 prot., datë 28.10.2022.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Dosku-Energy” sh.p.k., shoqërinë “C&S Construction Energy” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për këtë vendimarrje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR
Petrit Ahmeti